



Ne bazë të nenit 14 dhe nenit 58 pika a), b), d), g) i), të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, në bazë të nenit 3 paragrafi 1.4, 1.12 dhe 1.13, nenit 5, 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 dhe paragrafi 1 nen paragrafi 1.2, nenit 14, nenit 19 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr.10/03, Prill 2019), në bazë të nenit 13 dhe nenit 22 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 22 dhe 56 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Ligjit të Ndërtimit Nr.04/L-110, Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 Mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinorë), Rregulloren e MMPH Nr.03/2016 për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e banimit në Bashkëpronësi dhe Planit Rregullues Urban “Qendra” faqe 169, me propozimin e Kryetarit të Komunës të dt.25.07.2024, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.07.2024, merr këtë

## V E N D I M

### **PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01.Nr.VIII-2, dt.03.09.2015 PËR SHPALLJEN FITUESE TË OFERTAVE TË PËRZGJEDHURA PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË (99) VITE TË TOKËS NDËRTIMORE KOMUNALE ME KONKURS PUBLIK**


I. MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës dhe merret Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01.nr.VIII-2, dt.03.09.2015 për shpalljen fituese të ofertave të përzgjedhura për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vite të tokës ndërtimore komunale me konkurs publik

II.Ndryshohet pika II e Vendimit të lartëcekur, te LLOTI 4 - Ndërtimi dhe rregullimi i Objektivit Banesor-Afarist B+P+6 dhe B+P+7.Ndryshimi dhe Plotësimi duhet të bëhet te sipërfaqja nëntokësore e ndërtimit e ashtuquajtur Garazha-Parkingu, **ku nga sipërfaqja 877m<sup>2</sup> duhet të ndryshohet dhe të bëhet 1737.5m<sup>2</sup>**, e gjithë kjo duke u bazuar në Rregulloren e MMPH Nr.03/2016 për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e banimit në Bashkëpronësi- neni 27 pragrafi 2- “Numri i vend parkimit të automjeteve për njësitë e banimit duhet të jetë minimum një vend parkim për një banesë”. Si dhe neni 27 paragrafi 3. “Numri i vend parkimit të automjeteve për njësitë afariste, në kuadër të ndërtesës, duhet të jetë minimum një vend parkim për 30m<sup>2</sup>, neto sipërfaqe afariste, nëse me dokumente të planifikimit hapësinor nuk parashihet ndryshe”.

III.Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtoritë kompetente të Komunës së Deçanit.

IV.Vendimi hyn në fuqi 15(pesëmbëdhjet) dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

01.Nr.VII-9  
Deçan,dt.31.07.2024



Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ



Në bazë të nenit 12, paragrafi, 12.2 shkronja (c) të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), - Ligji për Arsimin në Komunitet e RK, Nr.03/L-068; në bazë të nenit 17 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për administratë të hapur në Komunë, në bazë të nenit 13 paragrafi 1.1, të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019 Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.07.2024, merr këtë:

## V E N D I M

### PËR VËNIEN NË KONSULTIM PUBLIK TË DRAFT – PLANI ZHVILLIMOR I ARSIMIT I KOMUNËS SË DEÇANIT 2024-2027

I.

Kuvendi i Komunës së Deçanit merr vendim për vënien në Konsultim Publik të Draft- PLANI ZHVILLIMOR I ARSIMIT I KOMUNËS SË DEÇANIT 2024-2027.

II.

Diskutimi publik zgjatë 30 ditë, përkatësisht prej datës 12.08.2024 deri me datën 12.09.2024, brenda së cilës Drejtoria për Arsim në koordinim me Zyrën për Informim mund të organizojnë diskutime/konsultime të ndryshme me palët e interesuara për këtë Draft-Plan, ndërsa Debat i përgjithshëm publik me qytetarë do të mbahet me dt.20.08.2024, duke filluar nga ora 14:00, në Sallën e Kuvendit kati i I-rë në objektin e Komunës.

III.

Pyetjet, vërejtjet, sugjerimet dhe komentet mund të drejtohen në Drejtorinë për Arsim ose në Zyrën për Informim.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim e Komunës së Deçanit.


V.

Vendimi hyn në fuqi 15(pesëmbëdhjetë) dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

01.Nr.VII-6

Deçan,dt.31.07.2024

Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ





Bazuar në Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 30 paragrafët 30.4 dhe 30.5, Ndryshohet dhe Plotësohet me Ligjin Nr. 05/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr.03/l-221, Nr.04/l-116, Nr. 04/l-194 dhe Nr. 05/l-063. Bazuar në Ligjin Nr.08/L-260 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 /neni 16 paragrafi 1. -Ndryshimet në shumat e ndara për projektet kapitale në kuadër të nën programeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 26 / 29 Dhjetor 2023), në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, dhe nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.07.2024, merr këtë:

## V E N D I M

### PËR RIALOKIM TË MJETEVE FINANCIARE NË KATEGORINË E INVESTIMEVE KAPITALE

I.

Merret Vendimi për Rialokim të mjeteve financiare në kategorinë e investimeve kapitale sipas të dhënave të prezantuara në vijim:

- Mjetet financiare nga projekti ekzistues “Ndërtimi i Objektivit të Ri të Komunës” kodi i projektit:21/631/18015/32000/55018/045, në të cilin është e planifikuar shuma prej 150,000.00 € nga Të Hyrat Vetanake.**

**Të Rialokohen në projektet ekzistuese:**

- “Ndërtimi i 4(katër) Urave për Roshkodol dhe Parku i fshatit Isniq”, me kod të projektit 21/631/18015/32000/55019/045, Vlera 40,000.00€, dhe**
- Projekti “Ndërtimi i Qendrës së Kolonive , Qendrës Rinore, Parqeve, Shesheve etj” me kod të projektit 21/631/18015/31510/53127/0451, Vlera 79,358.00€.**

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset, Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen:MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.VII-7

Deçan,dt.31.07.2024

	26502
K.K. DEÇAN AS	09.08.24
01	

Faqe 1 nga 1



Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, si dhe dispozitave të nenit 26 pika 7. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019. Në bazë të kërkesës së MAPL për Rishqyrtim të aktit Nr.020-333/6, dt.13.06.2024, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me dt.31.07.2024, merr këtë:

## V E N D I M

I. MIRATOHET Vendimi për anulimin e Vendimit Nr.IV/6 i dt.30.04.2024 për Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës së Deçanit me pronën e paluajtshme private.

II.Obligohet Komuna e Deçanit që të ndërmerr të gjitha veprimet e rekomanduara nga MAPL, me shkresën e dt.13.06.2024, Nr.020-333/6.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.

IV.Vendimi hyn në fuqi 15(pesëmbëdhjetë) dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7(shtatë) ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

01.Nr.VII-8

Deçan,dt.31.07.2024

Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ

